Unë i nënshkruari \_\_\_\_\_ me cilësinë \_\_\_\_\_ të operatorit ekonomik \_\_\_\_\_ deklaroj se kam në proces dhe/ose jam shpallur fitues për kontratat e mëposhtme:

<b>Nr.</b>	<b>Autoriteti kontraktor</b>	<b>Objekti i procedurës se prokurimi/kontratës</b>	<b>Vlera e shpallur fituese</b>

**Data e dorëzimit të deklaratës** \_\_\_\_\_

**Përfaqësuesi i ofertuesit**

**Nënshkrimi**

**Vula**

**Shënim:** Nërastin e bashkimit të operatorëve ekonomikë, secili prej anëtarëve të bashkimit duhet të plotësojë këtë deklaratë.

---

<sup>4</sup>Kjo deklarate ka si qëllim plotësimin e kriterit ligjor që operatori ekonomik brenda së njëjtës periudhë nuk është kontraktor/nënkontraktor për kontratë/kontrata të lidhura dhe/ose është shpallur fitues, me vlerë të përbashkët ose të veçantë, më të madhe se 100 % i kufirit maksimal, që disponon, sipas licencës profesionale, të lëshuar nga autoriteti kompetent

## Shtojca 12

[Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor]

### 1. KRITERET E PËRGJITHSHME TË PRANIMIT/KUALIFIKIMIT

Ofertuesi duhet të deklarojë se:

- a) Është i regjistruar në Qendrën Kombëtare të Biznesit dhe ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit. Në rastin kur ofertuesi është një organizatë jofitimprurëse, duhet të deklarojë se është i regjistruar si person juridik, sipas Ligjit Nr.8788, datë 07.05.2001 “Për Organizatat jo Fitimprurëse”.
- b) nuk është në proces falimentimi, (statusi aktiv)
- c) nuk është dënuar për shkelje penale, në përputhje me Nenin 45/1 të LPP,
- ç) nuk është dënuar me vendim të gjykatës së formës së prerë, për vepra që lidhen me veprimtarinë profesionale.
- d) ka paguar të gjitha detyrimet për pagimin e tatimeve e të kontributeve të sigurimeve shoqërore, sipas legjislacionit në fuqi.

Edhe Ofertuesi i huaj duhet të deklarojë se i plotëson të gjitha kërkesat e renditura më sipër nëpërmjet paraqitjes së një vetëdeklarate me shkrim.

Nëse gjuha e përdorur në procedurë është gjuha shqipe, atëherë dokumentat në gjuhë të huaj duhet të shoqërohen me një përkthim të noterizuar në gjuhën shqipe.

Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomikë, çdo anëtar i grupit duhet të dorëzojë vetëdeklaratën e lartpërmendur.

**Kriteret e Përgjithshme për Pranim, nuk duhet të ndryshohen nga autoritetet kontraktore.**

**Këto kritere duhet të plotësohen me dorëzimin e vetëdeklaratës me shkrim të subjektit, në ditën e hapjes së ofertës, sipas Shtojcës 8.**

**Në çdo rast, autoriteti kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik si më sipër.**

**Veç kësaj, nëse oferta dorëzohet nga një bashkim operatorësh ekonomikë, duhet të dorëzohen:**

- a. Marrëveshja e noterizuar sipas së cilës bashkimi i operatorëve ekonomikë është krijuar zyrtarisht;
- b. Prokura e posaçme.

## 2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

a. *Përshkrimin e Ofertës, sipas Shtojcës 1;*

b. *Deklaratë për paraqitje oferte të pavarur, sipas Shtojcës 1/1;*

c. *Sigurimoferte, (nëse është zbatueshme) sipas Shtojcës 3;*

ç. *Deklaratëmbi përmbushjen e Specifikimeve teknike, sipas Shtojcës 5;*

d. *Deklaratëmbi Konfliktin e Interesit sipas Shtojcës 7;*

dh. *Deklaratë mbi garantimin e zbatueshmërisë së dispozitave ligjore në marrëdhëniet e punës Shtojcës 8/1;*

e. *Formular vlerësimi sipas Shtojcës 9;*

f. *Deklaratëmbi disponueshmërinë e mjeteve sipas Shtojcës 10;*

g. *Deklaratë mbi kontratat e lidhura apo ne proces, sipas Shtojcës 11;*

gj. *Vërtetimin që konfirmon shlyerjen e të gjitha detyrimeve të maturuara të energjisë elektrike të kontratave të energjisë që ka operatori ekonomik që është i regjistruar në Shqipëri.*

2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

### 2.1. Kapaciteti ligjor i operatorëve ekonomikë:

Sipas Kriteve të përgjithshme të Pranim/Kualifikimit, pika 1 e shtojcës 12

2.1.2 Operatori ekonomik gjithashtu duhet të ketë:

-Kopje të Certifikatës elektronike për Fiskalizimin, për tatimpaguesit që përdorin Platformën Qëndrore të Faturave:

-Kopje të Certifikatës elektronike për Fiskalizimin dhe Kopje të vlefshme të Kontratës së lidhur me Shoqërinë e Certifikuar për zgjidhjen software-ike në përdorim, për tatimpaguesit që lëshojnë faturat nëpërmjet zgjidhjes software-ike

### 2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

1- Vlera mesatare e xhiros së realizuar gjatë tre viteve të fundit nga data e zhvillimit të tenderit të jetë jo më e vogël se 50 % e vlerës së fondit limit që prokurohet.

Në plotësimin e kësaj pike operatori ekonomik duhet të paraqesë:

a) Vertetim nga Dega e Tatim-Taksave për xhiron gjatë tre viteve të fundit (2017, 2018 dhe 2019)

b) Kopje të certifikuarave të bilanceve për tre vitet e fundit (2017, 2018 dhe 2019).

c) Vertetim të shlyerjes së detyrimeve vendore për vitin 2019 dhe 2020 në të gjitha adresat ku operatori/operatorët ekonomik ushtrojnë aktivitetin e tyre sipas të dhenave përkatëse të ekstraktit të QKB-se.

### 2.3 Per kapacitetin teknik:

#### 2.3.1 Përvojë e suksesshme në realizimin e të paktën:

- a) Punë të ngjashme e realizuar ne një kontrate te vetme me vlerë sa 50% e vleres se fondit limit, te realizuar gjatë tri viteve të fundit **ku zerat e punimeve respektive plotesojne kriteret minimale te preventivit te objektit ne prokurim.**

ose

- b) punë të ngjashme deri ne nje kufi ku vlera monetare totale e kontratave te punëve të kryera e marrë së bashku gjatë tre viteve të fundit është në një vlerë sa dyfishi i e vleres se fondit limit dhe që është realizuar gjatë tri viteve të fundit, **ku zerat e punimeve respektive plotesojne kriteret minimale te preventivit te objektit ne prokurim.**

Plotesimi i njerit prej dy kushteve te siperpermendura e ben oferten te kualifikueshme.

**2.3.1/a** Për kontrata të realizuara me autoritete publike, operatori ekonomik duhet të paraqesë dokumentacionin e mëposhtëm:

1. Formularin e vleresimit
2. Kontratën/Kontratrat
3. Situacionin përfundimtar;
4. Aktin e kolaudimit;
5. Çertifikaten/certifikatat e marrjes ne dorezim.
6. Faturat tatimore perkatese per cdo situacion

Per kontratat e realizuara si Bashkim Operatoresh duhet te paraqitet si vijon:

- Kontrata e Bashkim Operatoresh deklaruar ne fazen e tenderimit
- Prokura e posaçme e Bashkim Operatoresh deklaruar ne faze tenderimi

Ne rast se kontrata e paraqitur eshte realizuar si Nenkontraktor duhet te paraqitet si vijon :

- Kontrata baze ndermjet kontraktorit dhe autoritetit kontraktor
- Miratimi zyrtar si nenkontraktor zyrtar nga ana e autoritetit kontraktor

**2.3.1/b** Për kontrata të realizuara me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë dokumentacionin e mëposhtëm:

1. Formularin e vleresimit
2. Kontrate;
3. Lejen e ndertimit
4. Situacionin përfundimtar;
5. Akt kolaudimi objekti;
6. Çertifikaten e marrjes ne dorezim te objektit;
7. Fatura tatimore per cdo situacion punimesh.

*Pika 2.3.1/a plotësohet nga anëtari i cili ka përqindjen më të madhe të pjesëmarrjes në bashkim. Anëtarët e tjerë të bashkimit do të paraqesin kontratat e ngjashme në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim. Kurse pika 2.3.1/b duhet të plotësohet nga të gjithë anëtarët e bashkimit në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim.*

### 3.Licenca profesionale lidhur me ekzekutimin e punëve të kontratës.

Ofertuesi duhet të jetë i pajisur me liçencë profesionale të shoqërisë (sipas modelit të lëshuar Ministria e Transportit dhe Infrastruktura (ish-MPPT) me kategoritë:

**N.P -1 B** Punime gërmimi në tokë.

**N.P-4 D** Rrugë autostrada, ura, mbikalime, hekurudha, linja tramvaji, metro, hekurudhë me kavo dhe pista aeroportuale

**N.P- 5A** Punime nentokesore, ura e vepra arti

**NP-7 B** Ujësjellës, kanalizime, vepra kullimi e vaditje

**N.P – 12A** Punime të inxhinierisë së mjedisit.

**N.S – 6A** Sinjalistika rrugore jodriçuese

**N.S - 7A** Barriera dhe mbrojtje rrugore

**N.S – 18A** Punime topogjeodezike.

**N.S – 19A** Sistemet kundra zhurmes për infrastrukture

Për Operatorët e huaj të bëhet njëhësimi i liçencës profesionale që disponojnë nga vendi i origjinës pranë Ministrisë së Transportit dhe Infrastruktura (Ish Ministria e Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit), në plotësim të licencave profesionale të kërkuara për ekzekutimin e kontratës

**4Stafi Teknik i Shoqërisë të ketë në përbërje :**

1.Inxhinier Hidroteknik	1 (një)	
2.Inxhinier Ndertimi	1 (një)	
3.Inxhinier Ndertimi profili Transport		1 (një)
4.Inxhinier gjeodet/topograf/markshajder/gjeomatik		1 (një)
6.Inxhinier Mjedisi	1 (një)	
7.Inxhinier Mekanik	1 (një)	
8.Arkitekt profil Urbanist	1( një)	
9.Inxhinier Gjeolog	1( një)	

**Secili prej pjestarëve të stafit teknik të mësipërm, duhet jetë i pasqyruar në Liçencën e Shoqërisë dhe Listëpagesat te pakten 12(dymbëdhjete) muajt e fundit te punësuar me kohe te plote ne Shoqeri.**

**Per inxhinieret e mesiperm duhet te paraqitet:**

 **Kontratepunenoteriale e vlefshme**

 **Cv**

 **Diplome**

 **Librezepune**

5.Operatori ekonomik ofertues duhet te kete te punësuar stafin si me poshte:

- 2 Teknik ndertimi
  
- 1 Elektricist
  
- 2 Hidraulik

## Dokumenta Standarde të Tenderit

- 2 Mekanik
- 3 Karpentier
- 1 Montator
- 1 Specialist Montues Tubash
- 1 Specialist Ndertimi
- 1 Teknik Topograf
- 6 Manovrator
- 3 Shofer

Per punonjesit te paraqiten:

a)Kontrate pune e vlefshme

b)Deshmite e kualifikimittesigurimitteknik (te vlefshme),

c)Certifikate/Diplome Profesionale si dhe te figuroje ne listepagesat e shoqerise per te pakten 6(gjashte) muajt e fundit nga data e zhvillimit te tenderit.

d) Per punonjesit shoferet e paraqiten deshmit e kualifikimit te sigurimit teknik (IQT) ose ekuivalente dhe deshmi drejtimi, ndersa per punonjesit manovratore te paraqiten deshmit ekualifikimit te sigurimit teknik (IQT) ose ekuivalente dhe deshmi te aftesise profesionale dhe deshmi drejtimi.

Operatori/et ekonomik duhet të kenë në stafin e tyre personel të kualifikuar/ çertifikuar si:

- 1 (një) Inxhinier pjese e drejtuesve teknik te shoqerise të pajisur me Çerifikatë për Mbrojtjen e Shëndetit dhe te Sigurisë në punë, lëshuar nga autoritete të certifikuara.
- 1 (një) Inxhinier pjese e drejtuesve teknik te shoqerise Çertifikuar për Sigurimin dhe kontrollin e cilësise ISO 9001:2015.
- 1 (një) Inxhinier pjese e drejtuesve teknik te shoqerise te jetë i pajisur me Certifikatepër Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis (VNM) lëshuar nga Ministria e Mjedisit.
- 1(nje) nga inxhinieret pjese e drejtuesve teknik te shoqerise, duhet te jete i pajisur me certifikaten te Trajnimit për “Vleresimi dhe dokumentacioni i vleresimit te risqeve ne kantier”, “Pergjegjes per sigurine”, e dhëne nga nje organizem i licencuar certifikimi shqiptar ose i huaj.
- 1 (një) punonjësipajisur me çertifikatë “Ekspert për ndihmën e pare dhe ndërhyrjen ndaj emergjencave” e cila të jetë e lëshuar nga shoqeritë akredituara ose nga organizma ndërkombëtare akreditues të njohur nga Republika e Shqipërisë.
- 1 (një) punonjësi "Përgjegjës për dëmet në mjedis" gjatë kryerjes së veprimtarisë, nëpërputhje me klauzolat e ligjit Nr. 10431 datë 09.6.2011 “Përmbrojtjen e mjedisit”.
- 1 Inxhinier pjese e stafit te shoqërisë te jetë I pajisur me certificate per parandalimin dhe mbrojtje nga zjarri.

## Dokumenta Standarde të Tenderit

6.Kandidati ofertues duhet të përcaktojë me anë të një deklaratë të Administratorit të shoqërisë **Drejtnesin/(t) Teknik** të punimeve në objekt do të jetë/jenë i/ të pranishëm gjatë gjithë kohës që do të kryhen punimet në objekt dhe të jetë i pajisur me Diplomë, Kontratë pune, Librezë pune.

7.Operatori ekonomik duhet të paraqesi një dëshmi nga administrata tatimore për punesimin mesatar jo më pak se 140 punonjës për periudhën 6(gjashtë) muajt e fundit nga data e zhvillimit të tenderit shoqëruar me Listëpagesat e sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore dhe Formularët e Deklarimit të Pagesave.

8.Te këto në listepagese mjekun e shoqërisë të shoqëruar me kontratë pune noteriale, diplome, license /Urdher Mjeku.Ne rast bashkimi operatorësh secili nga operatorët duhet ta plotësojë këtë kusht.

9.Operatori ekonomik të këto në stafin e tij 1 (një) specialist Ekspert Zjarrfikës në fushën e mbrojtjes nga zjarri të rezultojë në listepagesat e shoqërisë për të paktën 6 (gjashtë) muajt e fundit nga data e zhvillimit të tenderit .

Detyrimisht të paraqitet kontratë pune noteriale dhe certifikata perkatese e dhene nga Drejtoria e MZSH ose certifikata perkatese të leshuara nga organizmat e vleresimit të konformitetit të cilat janë të akredituara nga DPA ose nga organizmat nderkombetare akreditues të njohur nga Republika e Shqipërisë.

10.Operatori ekonomik të këtë Licëncë për Mbrojtjen nga Zjarri të leshuar nga QKL.Kodi 1.2.A.

11.Operatori ekonomik të këtë Licëncë për Veprimtaritë e ekspertizës lidhur me ndikimin në mjedis (Auditim mjedisor ndikim në mjedis) Kodi III.2.A (1+2).

12.Operatori ekonomik duhet të jetë i pajisur me leje mjedisore të leshuara nga Qendra Kombëtare e Licensimit Tipi C Kodi III.1.A.për stacion transferimi për mbetje jo të rrezikshme.

13.Operatori ekonomik duhet të jetë i pajisur me leje mjedisore të leshuara nga Qendra Kombëtare e Licensimit për grumbullim dhe transportim të mbetjeve që kanë ndikim në mjedis Kodi III.2.B.

14.Operatori ekonomik duhet të jetë i pajisur me Licëncë të leshuara nga Qendra Kombëtare e Licensimit Kodi II.6.A Shërbime Shëndetësore për punonjësit e shoqërisë.

**15.Numri dhe lloji i makinerive,paisjeve në pronësi/qira: Dëshmi për mjetet e pajisjet teknike, që ka në dispozicion apo që mund t'i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën.**

*Mjetet dhe numri i tyre është përcaktuar bazuar në grafikun e punimeve, preventivin dhe orët e punës që duhet për të përmbushur kontratën.*

Nr	Emri i mjetit	Njesi	Sasi	Statusi
1.	Eskavator me zinxhire	Cope	2	Në pronësi ose me qera
2.	Eskavator me zinxhire me kapacitet 9 Ton	Copë	1	Në pronësi ose me qera
3.	Eskavator me goma	Copë	5	Në pronësi ose me qera
4.	Grejder	Copë	2	Në pronësi ose me



Dokumenta Standarde të Tenderit

				<b>qera</b>
5.	<b>Kamion vetëshkarkues me kapacitet mbajtes 30 ton</b>	Copë	1	Në pronësi ose me qera
6.	<b>Kamion vetëshkarkues me kapacitet mbajtes 10-18 ton</b>	Copë	2	Në pronësi ose me qera
7.	<b>Kamion vetëshkarkues me kapacitetmbajtes 10 ton</b>	Copë	2	Në pronësi ose me qera
8.	<b>Kamionçinë me kapacitet mbajtes 3.5-5 Ton</b>	Copë	1	Në pronësi ose me qera
9.	<b>Kamionçinë me kapacitet mbajtes jo me shume se 1 Ton</b>	Copë	2	Në pronësi ose me qera
10.	<b>Gurrëthyes, frontoje</b>	Copë	1	Në pronësi ose me qera
11.	<b>Nyje Inerte me QKL</b>	Copë	1	Në pronësi ose me qera
12.	<b>Fabrike asfalti me QKL</b>	Copë	1	Në pronësi ose me qera
13.	<b>Impiant betoni me QKL</b>	Copë	1	Në pronësi ose me qera
14.	<b>Autobitumatriçe</b>	Copë	1	Në pronësi ose me qera
15.	<b>Asfalto-shtrues</b>	Copë	1	Në pronësi ose me qera
17.	<b>Rrul gome-hekur 18 Ton</b>	Copë	2	Në pronësi ose me qera
18.	<b>Rrul gome-hekur 12 Ton</b>	Copë	1	Në pronësi ose me qera
19.	<b>Rrul hekur – hekur 3 ton</b>	Copë	3	Në pronësi ose me qera
20.	<b>Rrul asfalti me gomë – gomë kapaciteti 4 ton</b>	Copë	1	Në pronësi ose me qera
21.	<b>Rruli hekur-hekur me pak se 1Ton</b>	Copë	1	Në pronësi ose me qera
22.	<b>Gjysem rimorkio per transport mjetes</b>	Copë	1	Në pronësi ose me qera
22.	<b>Kompresor</b>	Copë	2	Në pronësi ose me qera
23.	<b>Autobot uji</b>	Copë	1	Në pronësi ose me qera
24.	<b>Freze asfalti</b>	Copë	1	Në pronësi ose me qera
25.	<b>Autobetoniere</b>	Copë	5	Në pronësi ose me qera
26.	<b>Autopompe Betoni</b>	Copë	2	Në pronësi ose me

Dokumenta Standarde të Tenderit

				qera
27.	Aparat topogjeodezik me GPS	Copë	1	Në pronësi ose me qera
28.	Mjet autovinç	Copë	2	Në pronësi ose me qera
29.	Fadromë Kovë përpara dhe mbrapa	Copë	4	Në pronësi ose me qera
30.	Depozite Uji 10.000 Litra	Copë	1	Në pronësi ose me qera
31.	Kontenier Stacioner (zyrë në objekt)	Copë	1	Në pronësi ose me qera
32.	Vibrator Betoni	Copë	2	Në pronësi ose me qera
33.	Mini Fadrome	Copë	1	Në pronësi ose me qera

Te paraqiten mjete dhe pajisje te mbrojtjes ne pune te punetoreve, personelit si me poshte:

- kokore minimum 50 (njqind) cope,
- jeleke minimum 50 (njqind) cope,
- fikese zjarrit e levizshme minimum 5 (pese) cope,
- komplet I ndihmes se shpejt minimum 5 (pese) cope,
- karrocadore minimum 10 (dhjete) cope.
- Kullë ndriçimi - minimumi 1 copë
- Për mjetet që shënohen në regjistra publikë, kur janë në pronësi, duhet të paraqitet dokumentacioni që vertetojnë pronësinë e mjetit:
  - çertifikatën e pronësisë;
  - leja e qarkullimit;
  - çertifikatën e kontrollit teknik;
  - siguracionin;
  - leja e transportit që leshohet nga njesia vendore dhe fotot perkatese;
 ndersa per mjete te marra me qera krahas dokumentacionit te mesiperm, duhet te paraqitet edhe kontrata e qerases e cila duhet te perfshije objektin perkates dhe duhet te jete e vlefshme per te gjithë periudhen e realizimit te punimeve deri ne perfundimin e plote te punimeve.
- Për mjetet që nuk shënohen në regjistra publikë, kur janë në pronësi, duhet të paraqitet kontrata e blerjes apo çdoganimi, fotot dhe fatura tatimore perkatese, ndersa per mjete te marra me qera krahas dokumentacionit te mesiperm, duhet te paraqitet edhe kontrata e qerases e cila duhet te jete per te gjithë periudhen e realizimit deri ne perfundimin e plote te punimeve.
- *Për mjetet e marra me qera të të paraqitet kontrata përkatëse noteriale e qirasë ku të specifikohet objekti i kontratës dhe afati i saj.*
- *Operatori ekonomik duhet të paraqesë foto për secilin mjet të deklaruar ku të jetë e dukshme dhe targa e mjetit.*
- *Autoriteti Kontraktor rezervon të drejtën të verifikojë dhe kontrollojë në çdo kohë deri në përfundimin e kontratës mjetet e pajisjet teknike të deklaruar sipas shtojcës Nr. 10. (Deklaratë nga administratori i shoqërisë ofertuese).*

## Dokumenta Standarde të Tenderit

- *Makineritë e mësipërme nuk janë të angazhuara në kontrata të tjera dhe nuk janë të deklaruara në procedurat të shpallura fitues nga autoriteti kontraktor (Deklaratë nga administratori i shoqërisë ofertuese ku të deklarohet dhe vendndodhja e mjeteve në pronësi ose me qera me qellim verifikimi).*
- Per Impiantin e prodhimit të asfaltobetonit duhet të paraqese planvendosjen dhe projektin teknologjik.

- ❖ Operatoriekonomikpjesëmarrësduhettëketënëpronësi, me  
geraostëketëkontratënoterialefurnizimipër:

a) Impiant prodhim Betoni me QKL

b) Impiant prodhim Inertesh me QKL

Përsa mësipër, OE duhet të paraqesin dokumentacionin e pronësisë, të marrjes me qera, apo kontratën noteriale të furnizimit, të shoqëruara me leje mjedisore nga QKL si mëposhtë:

**-QKL - Leje Mjedisi të tipit B, kodi III.1.B "Impiant betoni**, për prodhimin e produkteve të betonit", të shoqëruar me planvendosjen e Impiantit, monitorimin mjedisor .

**-QKL - Leje Mjedisi, kodi III.1.B "Impiant Inertesh"**

- ❖ Për impiantet e mësipërme, Operatori Ekonomik duhet të paraqesë raport-testimet për materialet si më poshtë:

- Raport-Testimin e materialeve Granil, Metoda e Testimit S SH EN 933-1:2012.

- Raport-Testimin e materialeve Rërë e Larë, Metoda e Testimit S SH EN 933-1:2012.

- Raport-Testimin për mostrën e betonit, Metoda e Testimit S SH EN 12390-1 : 3 2009.

- Raport-Testimin për ujin e betonit, Metoda e Testimit S SH EN 1008:2002.

Testimet e mësipërme duhet të jenë bërë nga një Laborator i Akredituar konform S SH ISO/EN 17025:2006

Raporti i testimeve duhet të jetë sipas standarteve në fuqi bazuar në ligjin ligjin Nr. 9290, datë 07/10/2004 "Për Produktet e Ndëtimin" Raportet e testimit duhet të jenë realizuar në 6-shtë mujorin e fundit.

16.Operatori Ekonomik duhet të disponojë dhe paraqesë çertifikatat të vlefshme:

- EN-ISO 9001 ( *Sistemi i menaxhimit të cilësisë*) ose ekuivalent
- EN-ISO 14001 (*Sistemi i menaxhimit të mjedisit*) ose ekuivalent
- BS OHSAS 18001 (*Sistemi i menaxhimit të shëndetit dhe sigurisë në punë* ose ekuivalent

**\*Te gjitha certifikata e mesiperme duhet të jene të lëshuara** nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë. (Në rastet e Bashkimit të Operatorëve ekonomik,

## Dokumenta Standarde të Tenderit

*çdo anëtar i grupit duhet të paraqesë perkatesisht Çertifikatën ISO sipas zerave të punimeve që do të marrë përsipër të realizojë sipas akt marrëveshjes).*

17.Operatori ekonomik pjesëmarrës në tender së bashku me preventivin duhet të dorëzojë analizë teknike për të gjithë zerrat e preventivit të ofertës. Mosparaqitja në formën e kërkuar përbën kusht për skualifikim. Bazuar në VKM Nr.514, datë 15.8.2007.

18.Operatori Ekonomik ofertues duhet të paraqese

- ❖ Metodologji të detajuar të aktivitetit të ndertimit (ofertuesit duhet të shpjegojnë të gjitha aktivitetet që do të kryhen për të arritur realizimin e objektit ).
- ❖ Një përshkrim i detajuar i mbështetjes teknike që Ofertuesi është në gjendje të ofrojë gjatë garancisë dhe vlefshmerisë së garancisë, sipas kërkesave të përshkruara në Aneksin B - Kushtet e Përgjithshme & Kushtet e Kontrates Tip dhe Aneksat.
- ❖ Cdo ofertues do të paraqese Plan Organizimin e punimeve në objekt të shoqëruar dhe me një relacion shpjegues & legjende, ku të reflektojë të gjitha masat tekniko-organizative dhe elementet e tjera që kërkon një plan organizimi i mirfillte.
- ❖ Çdo ofertues do të paraqesë Planin e Sigurisë në Kantier për punimet në objekt në format sipas VKM nr.692 datë 13.12.2001 "Përmasat e veçanta të sigurimit dhe ruajtjes së shëndetit në punë, të ndryshuar me VKM nr.742 datë 06.11.2000. Një përshkrim të detajuar të planit të Zbatimit të Kërkesave për Sigurimin Teknik dhe Shëndetit në Punë në përputhje me planin e Menaxhimit të Sigurimit Teknik dhe Shëndetit në Punë.
- ❖ Cdo ofertues do të paraqese edhe Grafikonin e Punimeve në përputhje me afatin e realizimit të punimeve të kërkuar

Të gjithë dokumentat duhet të jenë origjinalë ose kopje të noterizuara të tyre. Rastet e mosdorëzimit të një dokumenti, ose të dokumentave të rreme e të pasakta, konsiderohen si kushte për skualifikim.

### Shtojca 13

*(Shtojcë për t'u plotësuar nga autoriteti kontraktor)*

#### **PROJEKTI I ZBATIMIT DHE SPECIFIKIMET TEKNIKE**

**Përshkrimi i të dhënave teknike tëpunëve objekt prokurimi** të përshkruara sa më saktë dhe në mënyrë të plotë, duke krijuar kushte për konkurrim të paanshëm e të hapur ndërmjet të gjithë kandidatëve e ofertuesve. Kur është e mundur, specifikimet teknike duhet të përcaktohen në mënyrë të tillë që të kuptohen nga personat me aftësi të kufizuara.

#### **KUJDES**

Specifikimet teknike nuk duhet të kenë asnjë kërkesë apo referencë të ndonjë markë apo emër i veçantë, patentë, vizatim ose tip, origjinë specifike, prodhues ose sipërmarrës shërbimi, përveç rasteve kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme, e përshkrimit të kërkesave, me kusht që fjalët “ose ekuivalent” të përfshihen detyrimisht në këto specifikime.

Skicimet, Planimetritë e Objektit etj:

Specifikimet Teknike tëMaterialeve:

Grafiku i Punimeve:

Përshkrimi i kërkesave të zbatimit të shërbimeve në lidhje me to:

**Shtojca 14**

(Shtojcë për t'u plotësuar nga autoriteti kontraktor)

**PREVENTIV I PUNIMEVE**

**OBJEKTI:SISTEMIM ASFALTIM RRUGA SKENDERBEGAS LOTI 2**

**Investitori:Bashkia Gramsh**

Nr.	Nr.An	Emërtimi	Njësia	Sasia	Cmimi	Vlera
<b>I</b>		<b>PUNIME PER NDERTIMIN E RRUGES</b>				
1	3.87b	Germim dheu me eskavator goma 0.25 m <sup>3</sup> , ne kanale gjeresi > 2m, toke e zakonshme, Kategoria III	m <sup>3</sup>	4090		
2	3.205/1	Shtrese zhavori t=20cm perhapur e ngjeshur makineri	m <sup>2</sup>	18000		
3	3.212/b	Shtrese stabilizanti = 10 cm	m <sup>2</sup>	16000		
4	3.222/1	Shtrese binderi me granil gur kave 5 cm me makineri	m <sup>2</sup>	16000		
5	3.224/1	Shtrese asfaltobetoni 3 cm	m <sup>2</sup>	16000		
6	3.243/1	Struktura monolite te holla betoni C6/20(kuneta+kanal)	m <sup>2</sup>	320		
7	3.158/2a	Transport dheu me auto deri 2 km	m <sup>3</sup>	2200		
		<b>SHUMA I</b>				
<b>II</b>		<b>PUNIME PER NDERTIMIN E VEPRAVE TE ARTIT</b>				
1	3.87b	Germim dheu me eskavator goma 0.25 m <sup>3</sup> , ne kanale gjeresi > 2m, toke e zakonshme, Kategoria III	m <sup>3</sup>	2300		
2	3.244	Struktura monolite betoni C20/25 (mure mbajtes)	m <sup>3</sup>	350		
3	3.244	Struktura monolite betoni C20/25 (mure prites)	m <sup>3</sup>	980		
4	3.243/1	Struktura monolite betoni C16/20	m <sup>3</sup>	300		
5	3.An/1t	F.V tuba te brinjzuar HDPE SN8 d=315 mm	ml	112		
6	An-1	Pusete b/a shiu 50*70 cm h= 100 cm me kapak gize	cope	12		
7	3.363	Tombino me tuba betoni Ø 400, mbi shtrese betoni	ml	18		
8	3.365	Tombino me tuba betoni Ø 600, mbi shtrese betoni	ml	18		

Dokumenta Standarde të Tenderit

9	3.366	Tombino me tuba betoni Ø 800, mbi shtrese betoni	ml	60		
10	3.367	Tombino me tuba betoni Ø 1000, mbi shtrese betoni	ml	7		
11	3.158/2a	Transport dheu me auto deri 2 km	m3	792		
		<b>SHUMA II</b>				
		<b>PUNIME PER SINJALISTIKEN</b>				
1	An3(M3)	Guardrail N2 anesore me 2 valez ne nje ane W4 + aksesore	ml	380		
2	An57	Sinjale emer rruge L x H e vogel 60*20	cope	2		
3	An 105	Tabele trekendore e vogel me A = 60	cope	32		
4	An 119	Pervijues modulare te kthesave (qyfte)	cope	20		
		<b>SHUMA III</b>				
		<b>SHUMA I + II + III</b>				
		<b>T.V.SH= 20%</b>	<b>%</b>	20		
		<b>SHUMA TOTALE</b>				

**Shtojca15**

[Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor]

**NJOFTIM STANDART PËR OFERTUESIN E SKUALIFIKUAR<sup>5</sup>**

[Vendi dhe data]

[Emri dhe adresa e autoritetit kontraktor]

[Adresa e ofertuesit]

I/E Nderuar Z. /Zj. <emri i kontaktit>

Ju falenderoj për pjesëmarrjen në procedurën e lartpërmendur të prokurimit publik. Procedura e kryer në përputhje me Ligjin nr. 9643 datë 20.11.2006Për Prokurimin Publik.

Oferta juaj u vlerësua me kujdes sipas kushteve dhe kërkesave të përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e ofertës. Me keqardhje ju informoj se u s'kualifikuat, sepse oferta e dorëzuar nga ju u refuzua për shkak të arsyes (-ve) së/të mëposhtme:

---

---

---

---

Nëse mendoni se Autoriteti Kontraktor ka shkelur LPP ose RrPP gjatë procedurës së prokurimit publik, atëherë keni të drejtë të filloni një procedurë rishikimi siç parashikohet në Kreun VII të LPP-së.

Edhe pse nuk mundëm të përdornim shërbimet tuaja në këtë rast, besoj se do të vazhdoni të jeni i interesuar në nismat tona të prokurimit.

Me respekt  
<Emri>

---

<sup>5</sup> Ky njoftim duhet të përdoret në rastin e procedurave të prokurimit që zhvillohen në rrugë shkresore



**Shtojca 16**

[Shtojcë për t'u plotësuar Autoriteti Kontraktor]

**FORMULARI I NJOFTIMIT TËFITUESIT**

[Data \_\_\_\_\_]

Për: [Emri dhe adresa e ofertuesit të shpallur fitues]

Procedura e prokurimit:

Numri i referencës së procedurës/lotit:

Përshkrim i shkurtër i kontratës: [Sasia ose qëllimi dhe kohëzgjatja e kontratës]

Publikime të mëparshme (nëse zbatohet): Buletini i Njoftimeve Publike [Data] [Numri]

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit: çmimi më i ulët  oferta ekonomikisht më e favorshme

Njoftojme se, kane qenë pjesëmarrës në procedurë këta ofertues me vlerat përkatëse të ofruara:

1. \_\_\_\_\_

Emri i plotë i shoqërisë

numri i NIPT-it

Vlera \_\_\_\_\_

(me numra dhe fjalë)

2. \_\_\_\_\_

Emri i plotë i shoqërisë

numri i NIPT-it

Vlera \_\_\_\_\_

(me numra dhe fjalë)

Etj. \_\_\_\_\_

Janë skualifikuar ofertuesit e mëposhtëm:

1. \_\_\_\_\_

Emri i plotë i shoqërisë

numri i NIPT-it

2. \_\_\_\_\_

Emri i plotë i shoqërisë

numri i NIPT-it

Përkatësisht për arsyet e mëposhtme:

\_\_\_\_\_  
\_\_\_\_\_  
\_\_\_\_\_

\* \* \*

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë [emri dhe adresa e ofertuesit të shpallur fitues] se oferta e paraqitur, me një vlerë të përgjithshme prej [shuma përkatëse e

## Dokumenta Standarde të Tenderit

*shprehur në fjalë dhe shifra*]/pikët totale të marra [\_\_\_\_\_]është identifikuar si oferta e suksesshme.

Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqisni pranë [*emri dhe adresa e autoritetit kontraktor dhe referenca e kontaktit*] sigurimine kontratës, siç parashikohet në dokumentat e tenderit, brenda \_\_\_\_\_ ditëve nga dita e marrjes/publikimit të këtij njoftimi.

Në rast se nuk pajtoheni me këtë kërkesë, ose tërhiqeni nga nënshkrimi i kontratës, do të konfiskohet sigurimi i ofertës suaj (nëse është kërkuar) dhe kontrata do t'i akordohet ofertuesit vijues në klasifikimin përfundimtar, oferta e të cilit është dorëzuar me një vlerë të përgjithshme prej [*vlera përkatëse e shprehur në fjalë dhe shifra*], siç parashikohet në nenin 58 të Ligjit nr.9643 datë 20.11.2006“Për prokurimin publik”, i ndryshuar.

Njoftimi i Klasifikimit është bërë në datë \_\_\_\_\_

Ankesa: ka ose jo \_\_\_\_\_

(nëse ka) ka marrë përgjigje në datë \_\_\_\_\_

[Titullari i autoritetit kontraktor]

**Shtojca 17**

[ Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor në rastin e marrëveshjes kuadër]

**FORMULARI I NJOFTIMIT TË OPERATORËVE EKONOMIKË TË SUKSESSHËM NË MARRËVESHJEN KUADËR**

[Data]

Për: [Emri dhe adresa e operatorëve ekonomikë të shpallur fitues]

1. \_\_\_\_\_
2. \_\_\_\_\_
3. \_\_\_\_\_

\* \* \*

Procedura e prokurimit: \_\_\_\_\_

Numri i referencës së procedurës/lotit:

Përshkrim i shkurtër i kontratës: [Sasia, objekti, kohëzgjatja e kontratës etj]

Publikime të mëparshme (nëse zbatohet): Buletini i Njoftimeve Publike [Data] [Numri]

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit:  oferta ekonomikisht më e favorshme  çmimi më i ulët

Njoftojmë se, kanë qenë pjesëmarrës në procedurë këta operatorë ekonomikë, me shumatorën e çmimeve për njësi të ofruar/ me vlerat përkatëse të ofruara:

1. \_\_\_\_\_  
*Emri i plotë i shoqërisë* *numri i NIPT-it*

Shumatorja e çmimeve për njësi të ofruar/vlera \_\_\_\_\_  
*(me numra dhe fjalë)*

2. \_\_\_\_\_  
*Emri i plotë i shoqërisë* *numri i NIPT-it*

Shumatorja e çmimeve për njësi të ofruar/vlera \_\_\_\_\_  
*(me numra dhe fjalë)*

Etj. \_\_\_\_\_

Janë skualifikuar operatorët ekonomikë të mëposhëm:

1. \_\_\_\_\_  
*Emri i plotë i shoqërisë* *numri i NIPT-it*

2. \_\_\_\_\_

Dokumenta Standarde të Tenderit

*Emri i plotë i shoqërisë*

*numri i NIPT-it*

Perkatësisht për arsyet e mëposhtme:

---

---

---

\* \* \*

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë se janë identifikuar si operatorë ekonomikë të suksesshëm:

1. \_\_\_\_\_  
*Emri i plotë i shoqërisë* \_\_\_\_\_ *numri i NIPT-it* \_\_\_\_\_

Shumatorja e çmimeve për njësi të ofruar/Vlera \_\_\_\_\_/Pikët totale të marra \_\_\_\_\_  
(me numra dhe fjalë)

2. \_\_\_\_\_  
*Emri i plotë i shoqërisë* \_\_\_\_\_ *numri i NIPT-it* \_\_\_\_\_

Shumatorja e çmimeve për njësi të ofruar/Vlera \_\_\_\_\_/Pikët totale të marra \_\_\_\_\_  
(me numra dhe fjalë)

Etj.\_\_\_\_

Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqiteni pranë [emri dhe adresa e autoritetit kontraktor dhe referenca e kontaktit], brenda \_\_\_\_\_ ditëve nga dita e marrjes/publikimit të këtij njoftimi për të lidhur draft marrëveshjen.

Njoftimi i Klasifikimit është bërë në datë \_\_\_\_\_

Ankesa: ka ose jo \_\_\_\_\_  
(nëse ka) ka marrë përgjigje në datë \_\_\_\_\_

**[Titullari i autoritetit kontraktor]**

## Shtojca 18

### **KUSHTET E PËRGJITHSHME TË KONTRATËS Punët – Procedura e Hapur**

#### **Neni 1: Qëllimi**

- 1.1 Këto kushte të përgjithshme të kontratës (KPK) do të zbatohen për kryerjen e Punëve të prokuruarra ne bazë të legjislacionit të prokurimit.
- 1.2 Ligji për Prokurimin Publik në Republikën e Shqipërisë parashikon se dispozitat e Kodit Civil Shqiptar do të zbatohen për kontratat e prokurimit publik. Disa dispozita të Kodit Civil janë rishprehur në KPK me qëllim që të rrisin transparencën e kushteve të kontratës. Megjithatë, citimi i disa dispozitave këtu nuk mohon në asnjë mënyrë zbatimin e dispozitave të tjera të Kodit Civil të kësaj kontrate.
- 1.3 Në mënyrë të ngjashme, disa dispozita të Ligjit mbi Prokurimin Publik janë rishprehur në KPK me qëllim që të rrisin transparencën e ligjit që rregullon prokurimin publik. Megjithatë, citimi i disa dispozitave këtu nuk mohon në asnjë mënyrë zbatimin e dispozitave të tjera të Ligjit mbi Prokurimin Publik mbi të drejtat, detyrat dhe detyrimet e palëve.
- 1.4 KPK do të zbatohen deri në atë masë që të mos lënë mënjanë kushtet ose dispozitat e parashikuara në pjesë të tjera të kontratës.
- 1.5 Kushtet e kontratës përfshijnë gjithashtu Kushtet e Veçanta të Kontratës (KVK). Në rast se ka një konflikt midis KPK dhe KVK, KVK do të mbizotërojnë mbi KPK.

#### **Neni 2: Përkufizime**

- 2.1 “Preventiv total” do të thotë volumet e punes te dhena ne projekt te cilat jane orientuese, plotesuar me cmimin total të përcaktuar që është pjesë e Ofertes në një kontratë me çelsa ne dore.
- 2.2 “Preventiv per njesi” do të thotë volumet e punes te dhena ne projekt shoqeruar me cmimet per njesi te pandryshuara që janë pjesë e Ofertes në një kontratë me punime ne matje.
- 2.3 “Afatii realizimit te punimeve” do të thotë data që Punët duhet të perfundojnë siç është shprehur në Grafikun për realizimin Punimeve , e vertetuar nga enti prokurues.
- 2.4 “Kontratë” do të thotë marrëveshja e shkruar e lidhur midis Autoritetit Kontraktor dhe kontraktorit që përbëhet nga dokumentat e tenderit duke përfshirë KPK dhe KVK, të gjitha bashkangjitjet dhe formularët e plotësuar dhe të gjitha dokumentat e tjera që përfshihen në referimin e çdo dokumenti.

## Dokumenta Standarde të Tenderit

- 2.5 “Cmim kontrate” do të thotë çmimi që i paguhet kontraktorit sipas kontratës për zbatimin e plotë dhe të përpiktë të detyrimeve të tij kontaktore.
- 2.6 “Realizimi i punimeve” do të thotë data e vërtetuar nga Autoriteti Kontraktor se Punët janë mbaruar.
- 2.7 “Defekt” do të thotë çdo pjesë e Punimeve e paperfunduar në përputhje me kontratën.
- 2.8 “Data e hyrjes” do të thotë data që Autoriteti Kontraktor lejon kontraktorin në kantier.
- 2.9 “Data e fillimit” është përfshirë në Të dhënat e kontrates. Ajo është data kur kontraktori do të fillojë punimet e ndertimit. Nëse kjo nuk realizohet, “data e fillimit” do të jete dita në të cilën do të paguhet paradhenia.
- 2.10 “Pajisje” do të thotë makineritë dhe veglat e kontraktorit të sjella përkohësisht në kantier për realizimin e Ndertimeve.
- 2.11 “Materiale” do të thotë të gjitha furnizimet, duke përfshirë ato të konsumit, të përdorura nga kontraktori për kryerjen e punimeve.
- 2.12 “Objekt i kontratës” do të thotë të gjitha Punët që kontraktori do të sigurojë sipas kushteve të kontratës.
- 2.13 “Palë(t)” do të thotë nënshkruesit e kontratës.
- 2.14 “Drejtues projekti” do të thotë personi i emëruar nga Autoriteti Kontraktor që është përgjegjës për administrimin e kontratës për Autoritetin Kontraktor.
- 2.15 “Autoritet Kontraktor” do të thotë Autoriteti Kontraktor që është pjesë e kësaj kontrate dhe që kontraktori punët objekt i kësaj kontrate. Ky term kudo që përdoret ka kuptim të njëjtë me atë të perkufizuar në ligj.
- 2.16 “Kantier” do të thotë vendi fizik i Punimeve.
- 2.17 “Raport i inspektimit të kantierit” do të thotë dokumentat e përfshira në dokumentat e tenderit që pasqyrojnë informacion faktik dhe të interpretuar rreth kushteve të sipërfaqes dhe nëntokës së kantierit.
- 2.18 “Nënkontraktues” do të thotë çdo person fizik ose ligjor ose kombinim i mësipërm, që furnizon Punët, materialet ose pajisjet për ose në emër të kontraktorit.
- 2.19 “Kontraktor” do të thotë personi fizik ose juridik që është palë e kësaj kontrate dhe sipas dispozitave të kësaj kontrate siguron Punimet.
- 2.20 “Standarte Teknike” do të thotë specifikimet e aprovuara nga një trup i posaçëm standartizimi për zbatimin e vazhdueshëm ose të përsëritur. Standarte të tilla përdoren si rregulla, rregullore ose perkufizim të karakteristikave për të siguruar se materialet dhe shërbimet e procesuara i përgjigjen qëllimit.

- 2.21 “Ngritja e kantierit” do të thotë punimet e ndertimit të përkohshme, të ndërtuara e instaluara, që janë të nevojshme për zbatimin e punimeve të ndërtimit.
- 2.22 “Punime” do të thotë ajo që Autoriteti Kontraktor i kërkon nga kontraktori të gërmojë, ndërtojë, riparojë, rinovojë ose instalojë siç parashikohet në dokumentat e tenderit duke përfshirë shërbimet në lidhje me to, gjithashtu të përkufizuara në dokumentat e tenderit.

### **Neni 3: Hartimi i Kontratës**

- 3.1 Njoftimi i ofertes fituese do të shërbejë për hartimin e kontratës midis palëve, e cila duhet të firmoset brenda afatit të shprehur në dokumentat e tenderit.
- 3.2 Ekzistenca e kontratës do të konfirmohet me nënshkrimin e dokumentit të kontratës duke sanksionuar të gjitha marrveshjet midis palëve.

### **Neni 4: Praktikrat e Korrupuara, Konflikti i Interesit dhe Kontrolli i Procesverbaleve**

- 4.1 Autoriteti Kontraktor mund t’i kërkojë gjykatës të deklarojë të paligjshme kontratën nëse zbulon se kontraktori ka kryer veprime të korrupuara. Veprimet e korrupuara përfshijnë veprimet e përshkruara në Nenin 26 të Ligjit mbi Prokurimin Publik.
- 4.2 Kontraktori nuk duhet të ketë lidhje (të tashme ose të shkuara) me asnjë konsulent ose ent që ka marrë pjesë në përgatitjen e dokumentave të tenderit për këtë prokurim.
- 4.3 Kontraktori duhet të lejojë Autoritetin Kontraktor të inspektojë llogaritë dhe regjistrat që kanë lidhje me zbatimin e kontratës ose t’i kontrollojë ato me anë të kontrollorëve të emëruar nga Autoriteti Kontraktor.

### **Neni 5: Informacioni Konfidencial**

- 5.1 Kontraktori dhe Autoriteti Kontraktues duhet të mbajnë në konfidencë të gjitha dokumentat, të dhënat dhe informacionet e tjera të dhëna nga pala tjetër në lidhje me kontratën.
- 5.2 Kontraktori mund t’i japë nënkontraktorit dokumenta të tilla, të dhëna ose informacione të tjera që merr nga Autoriteti Kontraktor deri në masën e kërkuar që nënkontraktorin të zbatojë punën e tij sipas kontratës. Në rast të tillë, kontraktori duhet të përfshijë në kontratën e tij me nënkontraktorin një dispozitë që premtun ruajtjen e konfidencës siç thuhet në Paragrafin 5.1 më sipër.

### **Neni 6: Prona Intelektuale**

- 6.1 Me përjashtim të rasteve kur parashikohet ndryshe në kontratë, të gjitha të drejtat e pronës intelektuale të siguruara nga kontraktori gjatë zbatimit të kontratës do t’i përkasin Autoritetit Kontraktor i cili mund t’i përdorë ato sipas gjyqimit të tij.
- 6.2 Me përjashtim të rasteve kur parashikohet ndryshe në kontratë, kontraktori, pas përfundimit të kontratës, duhet t’i dorëzojë Autoritetit Kontraktor të gjitha raportet dhe të dhënat si hartat, diagramët, skicimet, specifikimet, planet, statistikat, llogaritjet dhe regjistrat mbështetës ose materialet e fituara, mbledhura ose përgatitura nga kontraktori gjatë zbatimit

të kontratës. Kontraktori mund të mbajë kopje të këtyre dokumentave dhe të dhënave, po nuk duhet t'i përdori për qëllime që s'kanë lidhje me kontratën pa leje paraprake me shkrim nga Autoriteti Kontraktor.

- 6.3 Kontraktori duhet të garantojë Autoritetin Kontraktor zhveshjen nga përgjegjësia për shkelje të të drejtave të pronës intelektuale, që mund të dalin nga përdorimi i materialeve, skicave ose çdo prone tjetër sipas kontratës.
- 6.4 Në rast se ngrihet ndonjë pretendim ose padi kundër Autoritetit Kontraktor në lidhje me ndonjë shkelje të pronës intelektuale të shkaktuar nga zbatimi i kontratës ose nga përdorimi i materialeve, skicave ose çdo prone tjetër të mbrojtur e të furnizuar sipas kontratës, kontraktori duhet t'i japë Autoritetit Kontraktor të gjitha provat dhe informacionin në posedim të kontraktorit që kanë të bëjnë me këtë padi apo pretendim.

#### **Neni 7: Origjina e Materialeve**

- 7.1 Nuk ka asnjë kufizim për kombësinë e origjinës së materialeve, përveç atyre që mund të jenë përcaktuar në ndonjë Rezolutë të Asamblesë së Përgjithshme të Kombeve të Bashkuara.
- 7.2 Kontraktori mund të jetë i detyruar të verifikojë origjinën e materialeve.
- 7.3 Për qëllime verifikimi “origjinë” do të thotë vendi ku materialet janë nxjerrë, bashkuar ose prodhuar. materialet janë prodhuar kur, nëpërmjet prodhimit, procesimit, ose mbledhjes së mjaftueshme të komponentëve, rezulton një produkt i ri i njohur në tregti që është mjaft i ndryshëm në karakteristikat bazë ose në qëllim apo përdorim nga komponentët e tij.
- 7.4 Origjina e materialeve ka dallim nga kombësia e kontraktorit ose nënkontraktorit që furnizon me materiale.

#### **Neni 8: Vendimet e Drejtuesit të Projektit**

- 8.1 Drejtuesi i projektit do të vendosë për çështjet e kontratës midis kontraktorit dhe Autoritetit Kontraktor
- 8.2 Drejtuesi i Projektit mund të delegojë ndonjë nga detyrat dhe përgjegjësitë e tij tek të tjerët përveç zgjidhjen e mosmarrveshjeve dhe konflikteve. Drejtuesi i projektit duhet të njoftojë kontraktorin për delegimet e bëra apo të revokuara.

#### **Neni 9: Komunikimi**

- 9.1 Çdo komunikim midis palëve duhet të bëhet me shkrim.

#### **Neni 10: Bashkëpunimi në Kantier me të Tjerët**

- 10.1 Kontraktori duhet të bashkëpunojë dhe të ndajë kantierin me firma të tjera, autoritete publike, shërbimet publike dhe Autoritetin Kontraktor siç kërkohet dhe përkufizohet në Grafikon e realizimit të punimeve.

#### **Neni 11: Përgjegjësia e Autoritetit Kontraktor**



- 11.1 Autoriteti Kontraktor ka përgjegjësi të kompensojë kontraktorin për dëmtime të pajisjeve të kontraktorit deri në masën që lidhet me veprime me faj të Autoritetit Kontraktor ose të projekteve të Autoritetit Kontraktor me perjashtim të rastit kur keto të fundit, kishin gabime të dukshme që mund të ishin konstatuar lehtësisht nga kontraktuesi.

**Neni 12: Raporti i Inspektimit të Kantierit dhe Kushtet e Kantierit**

- 12.1 Autoriteti Kontraktor nuk mban asnjë përgjegjësi për konkluzionet ose interpretimet e bëra në raportin e inspektimit të kantierit.
- 12.2 Kontraktori pranon se i ka marrë të gjitha hapat e nevojshme për të verifikuar natyrën dhe vendin e Punimeve dhe se ka inspektuar dhe pajtohet me kushtet e përgjithshme dhe lokale që mund të ndikojnë në kryerjen ose koston e Punëve.

**Neni 13: Kontraktori që Kryen Punimet**

- 13.1 Kontraktori duhet të kryejë dhe mbarojë Punimet në përputhje me specifikimet teknike të paraqitura në dokumentat e tenderit.
- 13.2 Kontraktori nuk mban përgjegjësi për gabimet në projekt, të dhëna, planimetri ose aspekte të tjera të specifikimeve teknike, të dhëna nga Autoriteti Kontraktor, me perjashtim të rasteve kur gabimi ishte aq i dukshëm sa kontraktori duhet ta kishte vënë re dhe ta kishte reklamuar këtë të Autoriteti Kontraktor.
- 13.3 Kodet dhe standartet që do zbatohen do të jenë të shprehura në dokumentat e tenderit. Nëse gjatë ekzekutimit të kontratës, ka ndryshime në zbatimin e kodeve ose standarteve, këto ndryshime do të zbatohen vetëm pasi të jenë aprovuar nga Autoriteti Kontraktor.

**Neni 14: Ekzekutimi i Punimeve**

- 14.1 Kontraktori duhet të fillojë zbatimin e kontratës menjëherë sapo ta lidhe atë dhe duhet t'i mbarojë Punët brenda Afatit të Mbarimit.

**Neni 15: Ngritja e Kantierit**

- 15.1 Kontraktori mban përgjegjësi për projektin e Ngritjes së Kantierit.
